

Kursi online 'Integrimi i Reformave Strukturore në Buxhete'

Njësia 1

Material për lexim

KËSHILLA DHE UDHËZIME SE SI TË SHKRUHET NJË PËRSHKRIM I MIRË I REFORMËS STRUKTURORE

Ky dokument synon që të kontribuojë në përmirësimin e strukturës dhe cilësisë së Programeve të Reformës Ekonomike (PRE) me fokus përshkrimi i masave të reformave strukturore (MRS) të përshkruara në Kapitullin 5 të dokumentit të PRE-së. Ajo ka për qëllim të shërbejë si një mbështetje për redaktuesit dhe shkruarit e MRS-ve duke u ofruar atyre udhëzime për tu siguruar që përshkrimi i MRS-së të jetë i qartë, konciz dhe i fokusuar në përmbajtjen që mundëson procese më të informuara të vendimmarrjes.

Kur shkruhet një përshkrim të MRS-së si pikënisje, shkruari ose redaktuesi i tij duhet të ketë parasysh dy parimet udhëzuese themelore:

a) Kush do ta lexojë këtë?

Lexuesit kryesorë të dokumentit të PRE-së janë hartuesit e politikave, partnerët socialë, politikanët, homologët e BE-së, gazetarët, qytetarët e angazhuar, etj. Kjo është arsyeja pse duhet të siguroheni që gjuha e përdorur të jetë e kuptueshme edhe për ta. Në veçanti, duhet t'i kushtoni vëmendje:

- Të hartoni strukturë të kuptueshme dhe të qartë për audiencën e publikut të gjerë.
- Lexuesit duan informacione të drejtpërdrejta, prandaj shmangni prezantimet e gjata dhe theksoni drejtpërdrejt thelbin.
- Shumica e lexuesve nuk do ta lexojnë tërë dokumentin, por vetëm atë që u intereson atyre.
- Shumë lexues i shikojnë vetëm titujt dhe fjalët kyçe me ngjyrë të theksuar.
- Përdorni konspekte dhe përmbledhje ekzekutive për të dhënë informatat kryesore.
- Përdorni tabelë të qartë dhe të strukturuar të përmbajtjes.

b) Çfarë po përpiqem të them?

- Jepni një përshkrim të shkurtër të problemit që duhet të adresohet.

- Tregohuni i saktë se cila është zgjidha dhe rezultati i pritur.
- Mos tregoni shumë detaje, të dhëna historike, akte ligjore....

Për të lehtësuar procesin e hartimit të një MRS-je, mund të ndiqni strukturën ashtu si përmendet në »[Shablloni i fletë-informacionit për përgatitjen e një mase të reformës strukturore](#)«.

Titulli i masës

- Përcaktoni një titull të pastër dhe konciz, duke përdorur fjalë kyçe.
- Titulli duhet të jetë tregues, i kuptueshëm dhe i shkurtër.

Për shembull:

JO	Përmirësimi i lidhjes në mes të arsimit dhe tregut të punës
PO	Arsimi i lidhur me nevojat e tregut të punës

JO	Krijimi i një sistemi më efikas të menaxhimit të potencialit për kërkime shkencore dhe inovacion
PO	Menaxhim efikas në shkencë dhe inovacion

JO	Përmirësimi i sektorit të komunikimit dhe shoqërisë së informacionit bashkë me harmonizimin rregullativ të kornizës rregullative me standardet e BE-së.
PO	Sektor efektiv i komunikimit dhe informacionit

Përshkrimi i masës

- Filloni fuqishëm: vendosni aspektin kryesor të idesë suaj në fillim.
- Fjalja dhe paragrafi hyrës duhet t'i tregojnë lexuesit se për çfarë po shkruani dhe pse ajo është e rëndësishme.
- Paraqitni një përshkrim konciz të masës duke treguar objektivin e synuar të çështjes, dhe ndërlidhjen me dokumentet strategjike kombëtare dhe/ose strategjitë sektoriale dhe përpjekjet më të gjera për reforma.
- Përdorni parimin e një fjalie kryesore me fjalë kyçe dhe përmbajtje.
- Përdorni fjali të shkurtra.

Për shembull:

JO	Pengesa kryesore në sektorin e infrastrukturës rrugore është investimi i pamjaftueshëm në ndërtimin dhe rindërtimin e rrugëve dhe autostradave gjatë tri dekadave të fundit. Domethënë, në periudhën e përmendur ka pasur një rritje të shumëfishtë të numrit të automjeteve në rrugë, d.m.th., transportit të mallrave dhe udhëtarëve nëpër rrugë, dhe në të njëjtën kohë kjo nuk është shoqëruar me ndërtimin e rrugëve të reja dhe rindërtimin e rrugëve ekzistuese në masën e nevojshme. Përveç kësaj, sipas standardeve të ndërtimit, jeta e planifikuar e përdorimit të një rruge të re të ndërtuar është rreth 20 vjet, pas së cilës ka nevojë të bëhet rindërtimi ose rehabilitimi i rrugës, në varësi të gjendjes së saj. E gjithë kjo rezulton në faktin se rrjeti ekzistues rrugor në autostradat dhe rrugët rajonale kryesore me ngarkesë të madhe të trafikut (PGDP) nuk ofron një nivel cilësor të shërbimit, d.m.th., ka bllokime, kolona në rrugë, vonesa të konsiderueshme në
----	--

	qarkullimin e udhëtarëve dhe mallrave. Pasoja e kësaj është numri i madh i aksidenteve rrugore në Federatën e Bosnjë dhe Hercegovinës. Sipas të dhënave zyrtare për vitin 2017, në aksidentet në trafikun rrugor ka pasur 170 viktima, dhe janë lënduar 6.809 persona.
PO	Në sektorin e infrastrukturës rrugore është nën-investuar. Është regjistruar një rritje e shumëfishtë e numrit të automjeteve dhe nuk është bërë rindërtimi dhe investimi i nevojshëm në infrastrukturën rrugore. Rrjeti ekzistues rrugor nuk ofron shërbim me cilësi të lartë, d.m.th. Ka bllokime, kolona, vonesa në qarkullimin e udhëtarëve dhe mallrave. Kjo gjithashtu rezultoi me numrin e aksidenteve rrugore me 170 të vdekur dhe 6.809 të lënduar që janë regjistruar në vitin 2017.

- Thjeshtoni formulimin; duhet të jeni kritik për tekstin që mund të fshihet pa e humbur kuptimin.
- Shmangni fjalitë e gjata dhe të vështira për tu përcjell që e humbin thelbin.
- Duhet të jeni të vetëdijshëm që masa e artikuluar mirë është bazë për llogaritje të mirë të kostove të saj.
- Përdorni tabela dhe grafikë të formatizuar mirë. Nuk është e nevojshme të përsërisni në tekst përmbajtjen e tabelave dhe grafikëve).

Për shembull:

JO	Me qëllim të zbatimit të plotë të Ligjit për Nënshkrimin Elektronik dhe zbatimin e nënshkrimit elektronik për administratën publike, qytetarët dhe subjektet afariste në të gjithë vendin në periudhën e mëhershme raportuese, Ministria e Komunikimit dhe Transportit e krijoi Zyrën për Mbikëqyrjen dhe Akreditimin e Verifikuesve në përputhje me nenin 20 të Ligjit për Nënshkrimin Elektronik të Bosnjës dhe Hercegovinës, i cili zyrtarisht filloi punën në 15 Janar 2018. Aktivitetet në fushën e nënshkrimit elektronik të realizuara nga Ministria e Komunikimit dhe Transportit në periudhën e kaluar janë
PO	Nënshkrimi elektronik do t'u mundësojë qytetarëve dhe biznesit që të përmirësojnë komunikimin me administratën publike dhe të rrisin produktivitetin dhe transparencën.

JO	Qëllimi i kësaj mase është të krijojë një kornizë ligjore për përcaktimin e parimeve themelore në mënyrë që të shkohet drejt një ekonomie qarkore, dhe të krijohet infrastruktura për menaxhimin adekuat të llojeve të veçanta të mbeturinave, d.m.th. të miratohen rregullore zbatuese që do të kontribuojnë në krijimin dhe forcimin e mekanizmave të ekonomisë qarkore, dhe të një sistemi për monitorimin e përdorimit të instrumenteve ekonomike në fushën e menaxhimit të mbeturinave.
PO	Qëllimi është të përcaktohen parimet themelore drejt një ekonomie qarkore. Kjo do të fillohet duke krijuar infrastrukturën për menaxhimin e llojeve të ndryshme të mbeturinave dhe një sistem për monitorimin e përdorimit të instrumenteve ekonomike në menaxhimin e mbeturinave.

- Mos e mbingarkoni tekstin me të dhëna të hollësishme dhe përshkrime të fakteve të kaluara.

Për shembull:

JO	Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore 2018, shkalla e punësimit është rritur në raport me një vit më parë dhe qëndron në 34.3%. Të dhënat administrative tregojnë se në vitin 2018 kishte mesatarisht 804.497 persona të punësuar, nga të cilët 341.521 ishin gra. Kjo paraqet një rritje krahasuar me një vit më parë, kur 784.094 persona ishin të punësuar (nga të cilët 329.922 ishin gra). Tregues të tjerë të sondazhit - shkalla e papunësisë dhe niveli i aktivitetit - gjithashtu shënuan një trend pozitiv. Përkundër kësaj, shkalla e lartë e papunësisë afatgjatë ende paraqet një sfidë shumë të madhe (68.6% e shkallës së
----	---

	përgjithshme të papunësisë përfshin personat e papunë për më shumë se dy vjet). Shkalla e pasivitetit në vitin 2018 ishte 57.9%, që do të thotë se vetëm 42.1% e popullsisë në moshë të punës është e punësuar ose kërkon punë.
PO	Shkalla e punësimit është rritur në 34.3%, e matur me anketën e Fuqisë Punëtore 2018. Të dhënat administrative tregojnë se ka qenë 804,5 mijë persona të punësuar, nga të cilët 341,5 mijë ishin gra. Kjo është një rritje e përgjithshme e punësimit prej 2.6% gjatë një viti dhe 3.5% për gratë. Megjithëse shkalla e papunësisë dhe niveli i aktivitetit janë përmirësuar, papunësia afatgjatë mbetet sfidë, pasi 68.6% janë të papunë për më shumë se dy vjet. Shkalla e pasivitetit ka mbetur e lartë në 57.9%.

- Shmangni referimin e ligjeve dhe sfondin ligjor nëse kjo nuk është thelbësore (përdorni fusnotat dhe referencat, vegëzat...).

Për shembull:

JO	Aktivitetet e planifikuara në periudhën 2020-2022: <ul style="list-style-type: none"> ○ Miratimi i Ligjit për Turizmin ○ Miratimi i Ligjit për hotelerinë me qëllim të harmonizimit të rregulloreve, me qëllim të aplikimit të zgjidhjeve sistemike për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve, dhe për të promovuar më mirë resurset në dispozicion për të rritur numrin e turistëve. ○ Miratimi i Ligjit për Taksën Turistike me qëllim të rritjes së të ardhurave nga turizmi. ○ Pasi të jetë miratuar legjislacioni i përgatitur, ato do të pasohen me aktivitete për hartimin e akteve nënligjore që rrjedhin nga ligjet e propozuara. ○ Zbatimi i ligjeve dhe akteve nënligjore
PO	Rritja e numrit të turistëve, netëve të qëndrimit dhe të ardhurave nga turizmi duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe promovimin më të mirë të resurseve në dispozicion, po ashtu edhe me aplikimin e taksës turistike.

- Përdorni foljet e veprimit më të fuqishëm.

Për shembull:

JO	për të kryer një analizë të
PO	për të analizuar

JO	për të arritur te marrëveshja për
PO	për tu pajtuar

- Kur të keni përfunduar tekstin, lexojeni përmbajtjen me kujdes.
- Kërkoni një kolegu që ta lexojë për ju.

Shijoni shkrimin tuaj!